



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 134 Datë 04.11.2020

PËR ALOKIM FONDI PËR VITIN 2020

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020: %".Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 04.11.2020 miratoi me 17 vota pro 1 kunder 0 apstenim.

VENDOSI

1. Në programin e investimeve të miratuar në buxhetin e Bashkisë Dibër për vitin 2020, si "Sistemim asfaltim i rrugicës në lagjen Kamen dhe lagjen Kallavere", "Rikonstruksioni i ujesjellesit Maqellare" fondet të cilat nuk janë realizuar procedurat e prokurimit, të cilat do të mbarten për investime në vitin 2021, kërkojmë pakësimin e tyre për këtë vit si më poshtë:

Të pakësohet :

Gr 0,0	Tit. 4520	Kap. 1	Art. 231	1,000,000	lekë	Kod Projekti "1060203"
Gr 0,0	Tit. 4520	Kap. 1	Art. 231	1,500,000	lekë	Kod Projekti "1060207"
Gr 0,0	Tit. 4240	Kap. 1	Art. 231	1,897,000	lekë	Kod Projekti "1060213"
Gr 0,0	Tit. 8220	Kap. 1	Art. 231	2,000,000	lekë	Kod Projekti "1060208"

Të shtohet :

Gr 0,0 Tit. 4240 Kap. 1 Art.231 1,500,000 lekë për "Shërbim mbikqyrje dhe kolaudim punimesh në objektet e bashkisë Dibër" me Kod Projekti "1060219".

Gr 0,0 Tit. 4240 Kap. 1 Art.231 2,051,378 lekë për "Rikonstruksioni dhe mirembajtje te kanaleve vaditese njesive administrative viti 2020" me kod projekti "1060220"

Gr 0,0 Tit. 8220 Kap. 1 Art. 231 2,845,622 lekë për investimin "Punimet per rehabilitimin e ambienteve në Pallatin e Kulturës "Haki Stermilli" Peshkopi.



2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmërine ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut Dibër.

